

**AKT – THEMELIMI**  
**I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**  
**"OMA" SHPK**

Sot me daten 06/09/2024 (dymijë e njëzet e katër ), unë ortaku themelues :

- *I Z. Tomas Kuçi, shtetas Shqiptar, i datëlindjes 27 Qershori 1998, lindur në Itali dhe banues në Durrës, person madhor e me zotësi të plotë për të vepruar, disponues i Leternjoftimit (kartë identiteti) me Nr. J80627082M.*

Në përputhje me Ligjin nr.9901 Datë 14.04.2008, si edhe Ligjin nr.9723 datë 3.5.2007, nenet 26,28,32 e 35 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit ",

Kam vendosur të themeloj Shoqërinë me Pergjegjësi të Kufizuar "OMA" SHPK.

**NENI 1.**  
**EMËRTIMI I SHOQËRISË**

Shoqëria do të quhet "OMA" SHPK.

**NENI 2**  
**SELIA E SHOQËRISË**

Shoqëria do të ketë selinë e saj në, Durrës, Rruga V.Xhymeri/7, Zona Kadastrale 8512, me Numër Pasurie 15/503-N20

**NENI 3**

**OBJEKTI I VEPRIMTARISË SË SHOQËRISË**

Tregti te artikujve te ndryshem industriale, veshjeve sportive. Prodhimi i fonogrameve të veprave muzikore, riprodhimi i fonogrameve të veprave muzikore, shpërndarja e fonogrameve të veprave muzikore, qiradhënia e fonogrameve te veprave muzikore, huadhënia publike e fonogrameve të veprave muzikore, r/transmetimi kabllor dhe autorizimi i r/transmetimit kabllor të fonogrameve të veprave muzikore, vënia në dispozicion të publikut në mënyrë ndërvepruese të fonogrameve të veprave muzikore. Blerja dhe shitja përmes kalimit në formë ekskluzive ose jo ekskluzive të te drejtave pasurore te kompozimeve muzikore, riprodhimi i kompozimeve muzikore, shpërndarja e kompozimeve muzikore, qiradhenia e kompozimeve muzikore, komunikimi në publik i kompozimeve muzikore, huadhenia publike e kompozimeve muzikore. Blerja dhe shitja përmes kalimit në formë ekskluzive ose jo ekskluzive të te drejtave pasurore të krijimeve të fjalës, të shprehura nëpërmjet shkrimeve letrare, riprodhimi, shpërndarja, qiradhenia, komunikimi në publik, huadhenia publike e krijimeve te fjalës, të shprehura nëpërmjet shkrimeve letrare. Krijimi i veprave muzikore të prejardhura përmes përshtatjes, përmes përpunimit, përmes aranzhimit muzikor si dhe përmes çdo transformimi tjetër që mund t'i

*Tomas Kuçi*  


bëhet veprës muzikore. Prodhimi, riprodhimi, shperndarja, qiradhenia, huadhenia publike, ritransmetimi kabllor dhe autorizimi i ritransmetimit kabllor, venia ne dispozicion te publikut ne menyre ndervepruese te fonogramit te veprave muzikore te prejardhura. Blerja dhe shfrytezimi pasuror përmes kalimit në formë ekskluzive ose jo ekskluzive të të drejtave pasurore të interpretimit dhe/ose ekzekutimit të aktorëve, këngëtarëve, muzikantëve, valltarëve, dirigjentëve te orkestrave ose të korit dhe personave te tjerë, të cilët paraqesin, aktrojnë, këndojnë, recitojnë, luajnë, interpretojnë, ekzekutojnë, që drejtojnë një orkestër ose që shfaqin në mënyra të tjera vepra letrare dhe artistike, një shfaqje të çdo lloji, përfshirë format e shprehjes së folklorit, varietete, shfaqjet e cirkut ose shfaqjet me kukulla. Drejtimi, zhvillimi, udhëheqja dhe mbrojtja e karrierës artistike profesionale të artisteve interpretues dhe/ose ekzekutues: aktorë, këngëtarë, muzikantë, valltarë, dirigjentë te orkestrave ose të korit dhe persona te tjerë, të cilët paraqesin, aktrojnë, këndojnë, recitojnë, luajnë, interpretojnë, ekzekutojnë, që drejtojnë një orkestër ose që shfaqin në mënyra të tjera vepra letrare dhe artistike, një shfaqje të çdo lloji, përfshirë format e shprehjes së folklorit, varietete, shfaqjet e cirkut ose shfaqjet me kukulla. Organizimi, prodhimi i veprimtarive artistike të çdo lloji, përfshirë koncertet muzikore të çdo lloji. Ndërtimi dhe menaxhimi i faqeve elektronike (website), mediave elektronike, mediave televizive etj. Komunikimi në publik përmes përcjelljes në publik, përmes paraqitjes publike, përmes transmetimit për publikun në internet ose jo në internet të reklamave të çdo lloji dhe të çdo forme, që parashikohen nga legjislacioni shqiptar. Prodhimi, riprodhimi, shpërndarja, qiradhënia dhe huadhënia publike, vënia në dispozicion të publikut në mënyrë ndërvepruese, paraqitja publike, duke përfshirë komunikimin në publik përmes përcjelljes në publik, përmes paraqitjes publike, përmes transmetimit audioviziv, përmes transmetimit për publikun në internet, të filmave kinematografikë, filmave televizivë, filmave të animuar, të reklamave të çdo lloji ose të filmave të tjerë, të videove të shkurtëra muzikore, të filmave dokumentarëve, të emisioneve dhe grafikave televizive si dhe të veprave audiovizuale të shprehura nga sekuanca të pamjeve levizëse të ndërlidhura, me ose pa zë pavarsisht nga natyra e mjetit në të cilën ato janë të fiksuar. Botimi, prodhimi, riprodhimi dhe shperndarja e revistave, gazetave, e krijimeve te fjales te shprehura nepermjet shkrimeve letrare, publicistike, shkencore si dhe te çdo krijimi tjeter me shkrim. Komunikimi ne publik permes shfaqjes publike ne faqet e internetit te krijimeve te fjales, te shprehura nepermjet shkrimeve letrare, publicistike, shkencore, te çdo krijimi tjeter me goje ose me shkrim, te lajmeve si dhe te informacioneve te shtypit qe kane karakter te thjeshte informimi. Prodhimi, shpërndarja, komunikimi në publik përmes shfaqjes publike në revstat, gazetat, faqet e internetit të krijimeve fotografike, duke përfshirë veprat fotografike si dhe të çdo krijimi tjeter që shprehet nga çdo proces i ngjashëm me atë fotografik , Organizime eventesh.

**NENI 4**  
**KAPITALI THEMELTAR I SHOQËRISË**

Kapitali themeltar i shoqërisë " OMA " **SHPK** është 100.000 (njëqind mijë) lekë. Ky kapital është i ndarë në 1 kuotë, me vlerë nominale 100.000 (njëqind mijë).

Kontributi i ortakëve është i ndare si vijon:

TOMAS KUCI  


**1. TOMAS KUCI zotëron 1 kuotë baraz me 100 % të kapitalit.**

**NENI 5  
KOHËZGJATJA E SHOQËRISË**

Shoqëria do të zhvillojë veprimtarinë e saj për një periudhe kohe të pacaktuar.

**NENI 6  
ADMINISTRIMI I SHOQËRISË**

Administrator i shoqërisë do të jetë

- 1- **Z. TOMAS KUCI**, i cill emërohet për një periudhë 5-vjeçare, me të drejtë ripërtëritje.

Administratori emërohet dhe shkarkohet me vendim të ortakëve, që përfaqesojnë me tepër se gjysmen e pjesëve të kapitalit themeltar.

Administratori ka të gjithë kompetencat për të vepruar në marredhënie me të tretë në emër të shoqërisë, me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep ortakëve.

Administratori mund të kryejë të gjitha veprimet e administrimit në interes të shoqërisë. Administratori është përgjegjës individualisht ndaj shoqërisë ose të tretëve për shkelje të ligjeve, statutit apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

**NENI 7  
ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E ORTAKËVE**

1. Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave. Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të ligjit "Per Shoqerite Tregtare".

2. Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuorumi të përmendur në pikën 1 të këtij neni, asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëtin rend dite.

**NENI 8  
NDARJA E FITIMEVE**

Fitimi që do të shpërndahet përbëhet nga fitimi i vitit finanziar, të cilit i janë zbritur shumat e lëna mënjanë për rezervën, si dhe duke i shtuar apo zbritur fitimet ose humbjet e mbartura nga vitet e mëparshme.

***Neni 9*  
LIKUJDIMI**

Shoqëria është në likuidim e sipër që në momentin e prishjes së saj, operacion i cili do të kryhet sipas kërkesave të parashikuara në legjislacionin tregtar shqipëtar.

*Tomas Kuci*



**NENI 10**  
**MOSMARRËVESHEJET**

Mosmarrëveshjet zgjidhen me mirëkuptim.Në rast të kundërt, ortakët themelues do ti drejtohen Gjykatës së Rrethit Durrës për zgjidhje.

**ORTAKËT THEMELUES TË SHOQËRISË**  
**"OMA" SH.P.K**  
**TOMAS KUCI**

TOMAS KUCI

